



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2022:100101
Datë: 26.03.2024
Numri i dokumentit: 05508198

PPP.nr.22/22

GJYKATA THEMELORE NË PEJË –Dega Istog, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni për Çështje Civile, me gjyqtaren Pajtesë Boshnjaku, në çështjen juridike përmbartimore të kreditores B.F nga fshati R., Komuna V., përfaqësuar nga Fatos Pira avokat nga Vitia , kundër debitores F.F nga fshati B., Komuna I., nga baza juridike përmbartimore pagesa e borxhit në bazë të dokumentit noterial, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit kundër Urdhrit të Përmbartuesit Privat Kushtrim M.Musa në Gajkovë P.nr.269/22 i datës 01.03.2022, jashtë seancës gjyqësore, me datë 26.03.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

I.PRANOHET PJESËRISHT I BAZUAR prapësimi i debitores F.F nga fshati B., Komuna I., i parashtruar kundër urdhrorit të Përmbartuesit Privat Kushtrim M.Musa në Gajkovë P.nr.269/22 i datës 01.03.2022 për shumën e borxhit të kërkuar prej 17,000.00 €.

II.REFUZOHET I PABAZUAR prapësimi i debitores për pjesën tjetër të detyrimit në të holla në shumën prej 15,000.00 €, të cilin detyrim në të holla obligohet pala debitore që ta përmbush ndaj kreditores.

A r s y e t i m

Kreditorja B.F nga fshati R., Komuna V., përmes të autorizuarit, me datë 18.05.2022, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbartimit në bazë të dokumentit notarial kontratës së shitblerjes LRP nr.6569/2021, baza juridike borxh në vlerë prej 32,000.00 €.

Përmbartuesi Privat duke vendosur në bazë të propozimit të kreditores me Urdhrin P.nr. 269/22 të datës 01.03.2022, ka lejuar përmbartimin e propozuar.

Debitorja në afatin e lejuar ligjor, me datë 17.03.2022 ka parashtruar prapësim kundër këtij urdhëri përmbarimor, duke theksuar se pjesërisht e kundërshtojnë urdhërin për përmbarim, ngase pjesërisht e ka përmbushur obligimin sipas kontratës së shitblerjës dhe atë në shumën prej 17,000.00, duke ia nashkangjitur prapësimin fletëpagesat për përmbushjen pjesërisht të çmimit kontraktues, gjegjësisht vlerën prej 17,000.00 euro.

Përfaqësuesi i kreditorit në afatin e paraparë ligjor nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim si dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se:

- prapësimi është i pjesërisht i bazuar për arsyet në vijim:

Dispozita nga neni 22 par.1 e LPP-së, përcakton llojet e dokumenteve në bazë të të cilave mund të caktohet përmbarimi. Në paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet: *“Dokumente përmbaruese janë: 1.3. dokumenti noterial i përmbarueshëm në pajtim me ligjin për noterinë”*. Në anën tjetër, dispozita nga neni 26 par.1, e cila i referohet përmbarueshmërisë së dokumentit të noterisë parasheh që *“Dokumenti i noterizuar është i përmbarueshëm nëse është bërë i përmbarueshëm sipas rregullave të veçanta që rregullojnë përmbarueshmërin e atij dokumenti.”* Elementet të cilat duhet t'i përmbajë një dokument përmbarimor janë të përcaktuara saktësisht në dispozitën e nenit 27 par.1 të LPP-së, ku parashihet: *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.”*

Gjykata me rastin e shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës erdhi në përfundim se titulli ekzekutiv në bazë të të cilit është lejuar përmbarimi, gjegjësisht, Kontrata e shitblerjes LRPnr.6569/2021 e datës 02.09.2021, i përmban të gjitha tiparet e dokumentit përmbarues dhe rrjedhimisht shërben si bazë për caktimin e përmbarimit, ngase i plotëson kushtet ligjore në kuptim të dispozitave nga nenet 22 par.1 pika 1.3, neni 26 par.1, dhe 27 par.1 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, për të qenë i përmbarueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarim ngase përmbanë kaluzolën e përmbarueshmërisë. Me dispozitën e nenit 21 parashihet se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.* Pra, në rastin konkret kontrata ka shërbyer si bazë për lejimin e përmbarimit.

Gjykata me rastin e vendosjes poashtu mori parasysh pretendimet e palës debitore, se pjesërisht e ka përmbushur borxhin, në vlerë prej 17,000.00 €, fakt të cilin e vlerësoi të provuar, duke u bazuar në provat bashkangjitur prapësimin, respektivisht fletëpagesës të datës 24.02.2022 nga e

cila rrjedh që debitorja t'ia ketë kompensuar shumën prej 12,000.00 euro kreditores dhe historiat i transfereve i datës 07.03.2022, nga e cila rrjedhë që debitorja t'ia ketë paguar kreditores shumën prej 5000,00 €, në shumë të përgjithshme prej 17,000.00 €.

Gjykata lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancën gjyqësore, duke ju referuar dispozitave ligjore të nenit 73 paragrafi 1 të LPP-së i cili përcakton se: *gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përgjithësisht gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit.*

Nga arsyet e theksuara me lartë, e në kuptim të nenit 73 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË – DEGA ISTOG
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL
PPP.nr.22/22, me datë 26.03.2024

Gjyqtarja
Pajtesë Boshnjaku

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimin të të njejtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.